

UJË PAK E NEVOJA SHUMË

Ndikimi i investimeve kapitale në mjedis

NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT H3 VIÇA

SHKURT 2020
PRISHTINË

UJË PAK E NEVOJA SHUMË

Ndikimi i investimeve kapitale në mjedis

**NDËRTIMI I
HIDROCENTRALIT
H3 VIÇA**

**SHKURT 2020
PRISHTINË**



HYRJE

Ndërtimi i hidrocentraleve të vogla dhe mini kishte nxitur një sërë reagimesh nga qytetarët e Kosovës gjatë viteve 2017-2019. Edhe pse procesi i ndërtimit të këtyre hidrocentraleve kishte filluar në vitin 2008, pasojat mjedisore kishin filluar të vëreheshin vetëm pas përfundimit dhe lëshimit të tyre në operim.

Duke marrë parasysh se plani për ndërtimin e këtyre hidrocentraleve kishte filluar qysh në vitin 2006, për një periudhë mbi 10 vitesh, kjo çështje kishte kaluar pothuajse në heshtje, dhe pa reagime. Por, kjo heshtje u thye me fillimin e protestave kundër HC në Kaçanik (2017) e që më pas, u përcoll nga protestat e zëshme në Pejë, Prizren dhe Shtërpçë (2019). Brengat e qytetarëve ishin me shumë vend, duke pasur parasysh resurset e limituara ujore në Kosovë, dhe problemet e shumta për sigurimin e ujit të pijshëm dhe ujitjen e tokave bujqësore. Për më shumë, qytetarët ishin neglizhuar nga qeveritë e një pas njëshme, duke mos qenë pjesë e vendimmarrjes lidhur me shfrytëzimin e resurseve ujore, si dhe duke mos u informuar lidhur me ndikimet e investimeve në mjedis. Por informatat për ndikimet e mundshme mjedisore nuk i posedonte as vet qeveria, meqë nuk ishte bërë një vlerësim strategjik dhe të detajuar lidhur me implikimet mjedisore që mund të kishin investimet e tilla. Reagimet nga qytetarët kishin bërë që disa punë në hidrocentrale të mos vazhdonin apo prolongoheshin, e që kishin shkaktuar rritjen e detyrimeve të investitorëve, me ç' rast neglizhenca e trajtimit të kësaj çështje kishte pasur një ndikim negativ edhe në komunitetin e biznesit.

Për më shumë, për shkak të shqetësimeve, dhe mungesës së kooperimit institucional, këto pengesa kishin nd-

ikuar edhe në mos-përmbushjen e kuotave strategjike të Kosovës për Energji të Ripërtrishme.

Ky hulumtim synon të ilustrtoj problemet nga tre palët kryesorë të interesit në këtë proces, qytetarët, investitorët dhe qeveria, në ndërtimin e hidrocentralit H3 Viça, në Komunën e Shtërpçës. Këto të gjetje janë të bazuara në mbi 40 takime me akterë të ndryshëm dhe mbi 500 materiale të konsultuara në periudhën qershor – nëntor 2019.

SFONDI

Nga viti 1999 e deri më tani, Kosova ka bërë progres në harmonizim e legjislacionit mjedisor me atë të BE-së. Me nënshkrimin e Traktatit të Energjisë¹, Kosova ka marrë përsipër implementimin e Direktivës së EU-së në territorin e saj. Sipas kësaj marrëveshjeje se deri në vitin 2020 nga bruto konsumi total i energjisë në vend, 20% e atij konsumi duhet të jetë kontribut i kapaciteteve të energjisë nga burimet e ripërtërishme. Si rezultat i procesit të lartpërmendur, Kosova në vitin 2013 kishte në shfrytëzim kapacitete të hidrocentraleve të vogla në kapacitet rreth 45 MW, ndërsa planifikonte që në vitin 2020 të arrinte kapacitetet totale prej rreth 286 MW, apo shtim me 85 % të kapaciteteve ekzistuese. Kjo, së bashku me kapacitetet tjera prodhuese nga burime të energjisë së ripërtërishme do të përbënte rreth 25% të konsumit të planifikuar të energjisë në të njëjtin vit².

Me 22.05.2006 Shoqata Shqiptare e Energjisë dhe Mjedisit për Zhvillim të Qëndrueshëm, me kërkesë të qeverisë së Kosovës, kishte dorëzuar në Ministrinë e Energjisë dhe Minierave të Kosovës, "Studimin e Parafizibilitetit për Identifikimin e Burimeve Ujore për Hidrocentrale të vegjël në Kosovë" (2006).

Sipas, këtij studimi problemet që dalin në projektimin e HC-ve të vegjël në të gjithë territorin e Kosovës janë si në vijim:

- Ndërtohen në zona të thella malore
- Rrjedhat ujore malore janë pak të monitoruara (sa dhe si duhet)
- Rrjeti meteorologjik (kryesisht reshjet) është i mangët

1 Sqarim: Hidrocentral I vogël, sipas legjislacionit në Kosovë, konsiderohet ai me kapacitet prodhimi nën 10 MW, ndërsa hidrocentrali mini ka kapacitet prodhimi nën 1 MW. Traktati i Komunitetit të Energjisë, <http://www.energy-community.org>

2 Ministria e Zhvillimit Ekonomik 2013

3 Raporti final: "Vlerësim i mëtejshëm i potencialeve për hidrocentrale të vegjël në Kosovë, viti 2010", fq. 48-49

4 Ministria për Zhvillim Ekonomik: [Raporti Potencialet e Kosovës për gjenerimin e energjisë ujore](#)

Sipas po të njëjtit studim, në Lumin Lepenc, thuhet se mund të ndërtohen 2 hidrocentrale si në vijim:

- 1) Hidrocentrali Brezovica, me rënie 60 m, prurje llogaritëse rreth 4.5 m³/sek, fuqi rreth 2100 kW dhe prodhim mesatar shumëvjeçar rreth 10 milionë kWh/vit.
- 2) Hidrocentrali Lepenci, me rënie rreth 60 m, prurje llogaritëse 7.6 m³/sek, fuqi rreth 3500 kW dhe prodhim mesatar shumëvjeçar rreth 16 milionë kWh/vit (figurat 26-30).

Ky studim parashihte mundësinë e ndërtimit të total 18 HC të rinj dhe rehabilitimin e 5 HC ekzistues në gjithë territorin e Kosovës. Në vitin 2009, për herë të dytë, Ministria e Energjisë dhe Minierave kishte kontraktuar prapë Qendrën Shqiptare për Zhvillim të Qëndrueshëm Energetik dhe Mjedisor, për të studiuar kapacitetet ujore për ndërtimin e edhe 41 hidrocentrale të vogla të tjera kundrejt vlerësimit të vitit 2006. Si rezultat i këtyre studimeve ishin identifikuar gjithsej 77 lokacione³ për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla në 4 pellgje lumore të Kosovës: Drin të Bardhë, Ibër, Moravë e Binçës, dhe Lepenc⁴.

Nga ky studim kishte rezultuar që në Lepenc kishte kapacitete për ndërtimin e 17 hidrocentraleve të vogla.

“

Si rezultat i këtyre studimeve ishin identifikuar gjithsej **77 lokacione** për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla në **4 pellgje lumore** të Kosovës: Drin të Bardhë, Ibër, Moravë e Binçës, dhe Lepenc. Nga ky studim kishte rezultuar që në Lepenc kishte kapacitete për ndërtimin e **17 hidrocentraleve** të vogla.



GJETJET KRYESORE

Pellgu i Lepencit ka kapacitetin më të vogël uJOR krahas tre pellgjeve tjera⁵, me sipërfaqe prej 0.685 kilometra katrorë dhe rrjedhje vjetore prej 307 milion kubik ujë. Ky

pellg përbëhet nga dy lumenj, ai i Nerodimes dhe Lepencit, dhe prek katër komuna jugore, atë të Ferizajt, Shtërpçës, Kaçanikut dhe Hanit të Elezit.

Në këtë pellg, ishin planifikuar të ndërtoheshin 17 hidrocentrale të vogla dhe mini, si në vijim:

#	Komuna	HC të vogla	HC mini	Total	Fuqia MW
1	 Ferizaj	4	4	8	11.648
2	 Shtërpçë	1	3	4	3.816
3	 Kaçanik	3	1	4	12.995
4	 Hani i Elezit	1	0	1	1.185
TOTAL		9	8	17	29.644

5 Drini i bardhë, 4,649 S[km2], Ibri 4,009 S[km2], Morava e Binçës 1,564 S[km2]



Në vazhdim, katër komuna e sipër cekura përfshijnë rreth 32,600 ha tokë bujqësore⁶ e cila kryesisht varet nga dy lumenjtë e këtij pellgu (Lepenci dhe lumi i Nerodimes). Në vitet e 70ta ishte bërë një studim i racionalizimit të resurseve ujore të Kosovës, ku si rezultat kishte dalur edhe projekti hidro-ekonomik Ibër Lepenci, i cili do të ofronte ujë të pijshëm dhe ujitje për tokat bujqësore që mbulonte territorin e pellgut të Lepencit dhe pjesërisht atë të Moravës

së Binçës. Megjithatë, për shkak të ndryshimeve politike gjatë fundit të viteve të 80'ta dhe vitet e 90'ta, faza e dytë e hidrosistemit Ibër-Lepenci⁷ kishte mbetur pa u përfunduar. Sot, vetëm rreth 7% e kësaj toke ujitet nga sisteme individuale komunale. Të dhënat në tabelën e më poshtme vetëm pjesërisht ilustrojnë rëndësinë e resurseve ujore, edhe ashtu të pakta, në territorin e pellgut të Lepencit⁸.

#	Komuna	Sipërfaqja e ujitur (ha)	Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore (ha)
1	 Ferizaj	688	18,708.00
2	 Shtërpçë	1,274	4,227.35
3	 Kaçanik	293	7,883.00
4	 Hani i Elezit	-	1,825.90
TOTAL		2,255	32,644.25

6 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural: Regjistrimi i Bujqësisë në Republikën e Kosovës 2014

7 Sipas Strategjisë së hidrosistemeve në Kosovë, 1982

8 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural: Regjistrimi i Bujqësisë në Republikën e Kosovës 2014





NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT H3 VIÇA NË KOMUNËN E SHTËRPECËS – PROBLEMET

KOMUNITETI

Edhe pse në një rajon me rrjedhje të shumta ujore, fshatrat e komunës së Shtërpçës për një periudhë shumë të gjatë ishin ballafaquar me probleme me furnizim me ujë të pijshëm, në mungesë të ujësjellësve⁹. Në shumicën e këtyre fshatrave, furnizimi me ujë bëhet nga burimet individuale (puset) apo ujësjellësit privat të ndërtuara nga donatorë të ndryshëm në periudhën 2000 – 2004, dhe të cilët nuk ishin bartur në pronësi komunale, apo kyçur në rrjetet e ujësjellësit rajonal.¹⁰

Këta ujësjellës privat kishin filluar të ballafaqoheshin me probleme të ndryshme pas vitit 2015 duke filluar nga degradimi i rrjetit e deri te shterja e burimeve furnizuese.

Një fat të tillë kishte pasur edhe fshati Biti e Poshtme. Ujësjellësi ishte ndërtuar si donacion në vitin 2002, por në fund të vitit 2019 banorët e fshatit kishin mbetur pa ujë, dhe pa adresë ku të kërkojnë ndihmë meqë ujësjellësi nuk ishte në pronësi institucionale. Gjithashtu, ky rajon që kultivonte qindra hektarë bujqësorë, nuk kishte sistem të ujitjes, por varej nga degëzimet e vogla të lumit Lepenc.

Njëri nga katër hidrocentralet e parapara për ndërtim në komunën e Shtërpçës – H3 Viça, ishte paraparë të ndërtohet në fshatin Biti e Poshtme dhe kishte shkaktuar shqetësime të shumta tek banorët e këtij fshati.

Fillimisht, në fazën parapërgatitore në vitin 2011, banorëve u ishte thënë jo-formalisht¹¹ se në fshatin e tyre do të ndërtohej një pendë e vogël, shtrati i lumit do të rregullohej, dhe do të shndërrohej në një vend që do të mund të joste turizëm malor. Meqë burimi kryesor i të ardhurave në këtë fshat janë ekonomitë familjare, kryesisht të varura nga rendimenti bujqësor dhe blegtoral, banorët i ishin gëzuar mundësisë së rritjes së ekonomisë së tyre me krijimin e mundësive për zhvillim të turizmit.

Por, raporti fillestar i vlerësimit të ndikimit të mjedis¹² për ndërtimin e këtij hidrocentrali, i dorëzuar nga investitori¹³, nuk parashihte një gjë të tillë. Ky vlerësim në fakt parashihte që 60-65% e rrjedhës së lumit do të futej në gypa në një gjatësi prej 3.8 km.

⁹ Sipas bisedimeve me banorë, drejtorja e urbanizmit pranë Komunës së Shtërpçës dhe CDF.

¹⁰ Sipas bisedimeve me banorë, Agjencinë e ujësjellësve dhe Kanalizimeve, dhe ujësjellësit rajonal "Bifurkacioni".

¹¹ Sipas deklaratës së banorëve. KDI nuk ka arritur të siguroj dëshmi nëse kjo informatë ishte dhënë nga MMPH apo nga Investitori.

¹² Vlerësimi i Ndikimit të Mjedis (VNM) është një proces sistematik që ka për qëllim vlerësimin paraprak të pasojave në mjedis të një projekti. Pra, për dallim nga mekanizmat tjerë të mbrojtjes së mjedisit, VNM ka funksion parandalues. Qëllimet e një VNM janë të shumfishta. VNM shërben si: (i) ndihmesë për vendim-marrje meqenëse ofron një analizë të implikimeve mjedisore të një projekti të propozuar para se të merret vendimi, (ii) ndihmesë për formulimin e zhvillimit të projektit meqenëse rekomandon aspektet ku mund të modifikohet një projekt me qëllim që ndikimet negative në projekt të minimizohen ose të eliminohen, (iii) instrument për zhvillim të qëndrueshëm.

¹³ Raporti mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis, MATKOS Group, Shkurt 2013



Mungesa e informatave lidhur me investimin dhe mënyrën e realizimit të hidrocentralit kishte shkaktuar revoltim të banorëve të këtij fshati. Ndërmjet viteve 2015 dhe 2019, këta banorë kishin organizuar rreth 200 protesta në kundërshtim të ndërtimit të këtij hidrocentrali në territorin e tyre. Shqetësimet e banorëve ishin të lidhura ngusht me implikimet e mundshme mjedisore, me një theks të veçantë në furnizimin me ujë të pijshëm dhe për agrikulturë. Sipas ligjit për ujërat i Republikës së Kosovës¹⁴, uji për pije dhe agrikulturë janë dy nevojat primare në shfrytëzimin e këtij resursi.



¹⁴ Ligji Nr.04/L-147 Për ujërat e Kosovës, Neni 28, Përparësitë për shfrytëzimin e ujërave



Përveç që komuniteti e kishte kuptuar se ndërtimi i këtij hidrocentrali nuk do t'i kontribuonte zhvillimit të turizmit, ata ishin të shqetësuar edhe për implikimet që ky projekt do të kishte në rendimentin bujqësor.

Në këtë territor janë rreth 200 hektarë të cilët punohen në mënyrë të vazhdueshme, nga të cilat rreth 100 janë të mbjella me mjedër (kryesisht donacion nga USAID), dhe pjesa tjetër ishin të mbjella me misër dhe grurë.

Gjatë vitit 2019, rendimenti nga mjedrat ishte rreth **500 ton**, të shitura me një çmim mesatar prej **1.3€ për kilogram**. Arkëtimet nga këto shitje përllogariten rreth **650,000.00€ bruto**, e që është e një rëndësie të veçantë për këtë fshat malor.

Çdo ndërhyrje e dëmshme në këtë rendiment rrezikon të varfërojë ekonominë familjare, të cilat janë të varura nga gjenerimi i të hyrave nga bujqësia. Këto shqetësime ndoshta do të mund të evitoheshin nëse kërkesat ligjore¹⁵ dhe kushtetuese¹⁶ për përfshirjen e qytetarëve në procesin e konsultimit dhe vendimmarrjes lidhur me zhvillimet të cilat mund të kenë ndikim në mjedisin ku ata jetojnë të ishin respektuar.

Sipas ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, investitori duhet të mbaj një debat publik në afat prej njëzet (20) deri tridhjetë (30) ditësh pas informimit të autoriteteve mjedisore dhe publikut të interesuar. Ky debat duhet të organizohet në përputhje me aktet nënligjore të rregulluara nga Ministria e Mjedisit.¹⁷ Ky akt nënligjor vetëm ilustronte kërkesat lidhur me informatat që duhej të përmbante njoftimi për mbajtjen e debatit, dhe kërkonte që njoftimi të bëhej përmes një shpalljeje lokale. Udhëzimi administrativ nuk rregullonte lokacionin e mbajtjes apo pjesëmarrjen minimale të pranueshme për t'u siguruar që çështja është diskutuar me publikun përkatës. Këto mangësi nuk ishin evituar as në versionin e përditësuar të këtij dokumenti,¹⁸ i cili hyri në fuqi në dhjetor 2015. Ky Udhëzues Administrativ, edhe pse në harmoni me ligjet aktuale, nuk është në frymën e marrëveshjeve ndërkombëtare,¹⁹ sidomos rreth pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimmarrëse me ndikim në mjedis dhe klimë.

Në rastin specifik, sipas legjislacionit jo të definuar mirë, investitori kishte organizuar dy debate publike për ndërtimin e hidrocentraleve në lumin Lepenc. I pari ishte mbajtur në tetor 2012 në komunën e Kaçanikut,²⁰ ndërsa i dyti në Brezovicë²¹ me 08.05.2013, megjithatë në të dy debatet nuk kishte fare përfaqësues nga komuniteti i prekur,

me përjashtim të investitorit dhe institucioneve publike (përfaqësues nga Komuna dhe Ministria e Mjedisit). Edhe pse mungesa e qytetarëve në këto debate do të duhej të shërbente si një indikator për keq-organizim ose mos-informim të publikut, megjithatë, Ministria kishte cilësuar se ishin përmbushur detyrimet ligjore për të dhënë pëlqimin mjedisor.

Banorëve të fshatit Biti e Poshtme u ishte mohuar e drejta ligjore për të qenë pjesëmarrës në vendimmarrje lidhur me investimet mjedisore në lokalitetin e tyre duke mos u informuar nga ministria lidhur me propozim vendimin, përmbajtjen e saj, ndikimet e mundshme dhe si të vepronin nëse ata kishin ankesa.

Bazuar në obligimet ligjore, pas vendim-propozimit për pëlqimin mjedisor, Ministria do të duhej të informonte publikun lidhur me vendimin në fjalë, dhe të vejë në dispozicion për inspektim publik një deklaratë lidhur me përmbajtjen e vendimit dhe kushtet e përcaktuara, arsyet dhe elementet bazë të vendimit, masat për shmangien apo mënjanimin e ndikimeve të theksuara dhe këshillat juridike dhe mjetet për ankimim lidhur me procedurën në fjalë.

Neglizhenca institucionale vetëm sa kishte rritur pakënaqësitë dhe dyshimet e banorëve për keqpërdorime në dëm të mjedisit dhe të tyre.

15 Ligji nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20 dhe Neni 22, paragrafi 4

16 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 52

17 Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 09/2011 për informimin, pjesëmarrje të publikut dhe të palëve të interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis

18 Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 16/2015 për informimin, pjesëmarrje të publikut dhe të palëve të interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis

19 United Nations: Rio Earth Summit, 1992; Aarhus Convention (1998), dhe Direktiva e BEe 2003 për pjesëmarrjen e publikut

20 Distanca Biti e Poshtme – Kaçanik: 24 km

21 Distanca Biti e Poshtme – Brezovicë, Hotel Woodland: 15 km

INVESTITORI

Konform legjislacionit për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë²², MZHE/ZRRE kishte thirrur investitorët potencial të shprehin interesimin e tyre. Për të joshur investimet private në këtë sektor, MZHE kishte hartuar skemën mbështetëse të Feed-in tarifës për energjinë nga uji dhe ajri, si dhe kishte ofruar kontrata afatgjate prej 10 vitesh në rastin e hidrocentraleve të vogla.

Në përgjigje të kësaj thirrje, nga viti 2010 deri në vitin 2019 ishin lajmëruar 14 kompani të cilat përmbushnin kushtet për pranim në skemën mbështetëse të gjenerimit të hidro-energjisë në Kosovë, për investime në 29 hidrocentrale të vogla dhe mini. Deri më tani, MZHE/ZRRE ka lëshuar 25 autorizime finale, nga të cilat 13 janë në operim²³. Kapaciteti prodhues i 25 HC të cilat posedojnë këto autorizime është 107.6 MW, respektivisht rreth 37.6% e prodhimit të planifikuar nga qeveria që të arrihej deri me 2020.

Një nga investitorët e autorizuar nga ZRRE për investime në hidro-energji, ishte MATKOS Group, të cilët kishin marrkatër autorizime finale nga ZRRE për ndërtimin e HC në komunën e Shtërpçës. Ministria e Mjedisit kishte dhënë pëlqimin mjedisor për ndërtimin e H3 Viça me 28.06.2013, pasi investitori kishte pranuar pëlqimet mjedisore dhe lejet përkatëse komunale²⁴.

Edhe pse investitori posedonte lejet dhe pëlqimet e nevojshme për ndërtimin e HC H3 Viça, protestat e vazh-

dueshme të komunitetit lokal kishin bërë që punimet e filluara në vitin 2015 të mos përfundonin ende. Përveç kostos së rritur të investimit (pagesa e punëtorëve dhe makinerisë ndërtimore) dhe detyrimet bankare të cilat investitori ishte i obliguar të fillonte t'i paguante pa arritur të gjeneronte fitim, investitori kishte edhe ankesa të dëmtimit të pronës private (makinerisë) nga komuniteti, e që kishte pasuar me prezencën e policisë gjatë zhvillimit të pjesshëm të investimeve për sigurimin e vend punishtës²⁵.

Neglizhenca e vazhdueshme nga institucionet përkatëse në adresimin e brengave të komunitetit kishte ngritur shqetësime edhe në komunitetin e investorëve në sektorin e energjisë.

INSTITUCIONET PUBLIKE

Sipas legjislacionit në fuqi, KDI vlerëson se, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe qeverisjes së mirë, procesi për marrjen e lejes përfundimtare për investime në hidroenergji është mjaft rigoroz dhe i ndërlkuar. Për të marrë një leje përfundimtare të prodhimit, ky proces i nënshtrohet 15 procedurave aprovuese²⁶ të rregulluara nga legjislacioni²⁷ përkatës dhe dikasteret përkatës qeveritar²⁸. Në vitin

22 Udhëzuesi për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë

23 Regjistri i aplikacione vepër ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese dhe pranim në skemën mbështetëse nga BRE

24 Pëlqimi nga Kuvendi Komunal Shtërpçe 29.03.2013, Pëlqimi mjedisor nga MMPH 13-1016-3-117 DMM (03.12.2013), Certificate kadastrale P-72717029-01760-0, KEDS-Pëlqimi elektro energjetik-HC-Vice, 30.05.2014, Verifikimi nga MMPH 01.08.2014/DGIS nr.prot. 14-3721, Kontrata mbi krijimin e servitutit sendor, KK Shtërpçe 11.04.2013, Pëlqimi mjedisor 13/1016/3 ZSP 2013/13 (9/12/20013) dhe Pëlqimi mjedisor 14/3721/1-337/DMM (08/09/2014) për rritjen e kapaciteteve të HC nga 2.5 MW në 4.8 MW.

25 Sipas deklaratave të invetitorit, ZRRE dhe komuneteve të pranuar.

26 (1) Studimi i fizibilitetit, (2) Elabortai gjeomekanik, (3) Pëlqimi nga komuna për investim, (4) Projekti zbatues, (5) Vlerësimi i ndikimit në mjedis, (6) Debat i Publik (7) Pëlqimi mjedisor, (8) Leja Ujore, (9) Pëlqimi për ujësjellës dhe kanalizim, (10) Pëlqimi për kycje në rrymë (11) Leja e ndërtimit (nga Komuna nën 10 MW komuna, mbi 10 MW MMPH), (12) Autorizimi final nga ZRRE, (13) Leja e integruarmjedisore, (14) Certifikata për përdorim dhe (15) Kërkesa për lëshim të lejes se prodhimit nga ZRRE (mbi 5kW)

27 Ligji Nr. 03/L-184 për Energjinë, Ligji Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë, Ligji Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike, Ligji Nr. 03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit, LIGJI Nr. 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis, LIGJI Nr. 03/L-230 për vlerësimin strategjik mjedisor, Ligji Nr.04/147 për ujërat e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës, Ligji Nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

28 Ministria e Mjedisit (AMMK, DMMU, ARPL, Departamenti për inspektim të mjedisit, Agjencia Kosovare e Pyjeve, Drejtoria e Parkut kombëtar përkatës



2016, me qëllim për të ndihmuar investitorët në investimet për energji, MZHE kishte iniciuar e One-Stop-Shop²⁹ për burimet e ripërtitshme të energjisë, me ç'farë synohej të reduktoheshin procedurat dhe barrierat e mundshme në marrjen e lejeve të nevojshme për investime³⁰.

Megjithatë, në procesin e drejtpërdrejtë të ndërtimit të hidrocentraleve përfshihen tre institucione qeveritare, Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik/Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Përderisa komunat japin pëlqimet dhe lejet për shfrytëzim të pronës komunale dhe lejet e ndërtimit, Ministria e Mjedisit është akteri kryesor në mbrojtjen e mjedisit, dhe racionalizimin e resurseve natyrore.

Gjatë hartimit të strategjisë kombëtare për energji të ripërtitshme, MMPH, edhe pse ishte pjesë e grupeve punuese dhe Këshillit Ndër-ministral të ujërave, nuk kishte shfaqur asnjëherë shqetësime rreth investimeve të parashikuara në lumenjtë e Kosovës, dhe implikimet mjedisore që mund të shkaktojnë këto investime.

Ministria e Mjedisit, sipas kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, bartë përgjegjësitë kryesore në mbrojtjen e mjedisit, si më poshtë:

- Është përgjegjëse për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, mjedisit jetësor dhe trashëgimisë kombëtare;
- Është përgjegjëse për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.
- Siguron që ndikimet në mjedisin jetësor merren parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.

Megjithatë, edhe përkundër përgjegjësisë së sipërcekura, ndikimet mjedisore nga ndërtimi hidrocentraleve nuk trajtohen në asnjërin nga raportet e MMPH, madje as ato vjetoret. Për më shumë, MMPH edhe pas shumë ankesave nga komuniteti lokal, nuk kishte kërkuar një pezullim të strategjisë deri në hartimin e një vlerësimi strategjik të ndikimeve mjedisore nga ndërtimi i hidrocentraleve.

Raportet e inspektimit të ndërtimeve të hidrocentraleve nuk ngritnin shqetësime për degradime mjedisore, dhe për implikime të mundshme në burimet ujore të shfrytëzueshme për pije apo ujë³¹.

Kjo Ministri kishte qëndruar e heshtur edhe ndaj protestave të vazhdueshme të qytetarëve të Bitisë së Poshtme, duke mos u ofruar sqarime, apo duke mos pezulluar pëlqimin mjedisor për ndërtimin e hidrocentralit deri në një vlerësim të detajuar të ndikimeve të mundshme mjedisore.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik ishte ajo që ishte angazhuar në studimet e potencialeve të energjisë së



ripërtrishme³² në Kosovë, dhe caktimin e caqeve të prodhimit mbi këtë bazë. Si opsion më i lehtë dhe i shpejtë i investimeve, MZHE nga viti 2006 deri në vitin 2010 kishte rritur caqet e prodhimit nga ky burim³³ për afër 59%³⁴. Për më shumë, vlerësimet e mëtejme të potencialeve për hidrocentrale të vogla, të bëra nga Qendra Shqiptare për Zhvillim të Qëndrueshëm Energjetik dhe Mjedisor, me kërkesë të MZHE, të viteve 2009 dhe 2010, ngrisin shqetësime lidhur me vjetërsinë e të dhënave hidrologjike dhe meteorologjike, që shërbenin si bazë e matjes së kapaciteteve ujore. Përkundëjt këtyre shqetësimeve, në përgjigje të Direktivës 2009/28/KE për Burimet e Ripërtitshme të Energjisë, MZHE kishte aprovuar strategjinë e energjisë. Në përgjigje të shqetësimeve të qytetarëve, dhe reagimeve të shumta nga organizatat e shoqërisë civile për mbrojtje të mjedisit të shpërfaqura gjatë periudhës 2017 - 2019, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në fillim të vitit 2019 kishte hartuar një draft udhëzues administrativ lidhur me caqet e energjisë së ripërtrishme nga burimet ujore, por që fatkeqësisht, në mungesë të vullnetit politik, kishte mbetur pa u aprovuar. Në përgjigje të shqetësimeve të qytetarëve, dhe ndikimet potenciale mjedisore, MZHE³⁵ kishte filluar rishikimin e strategjisë kombëtare për energji të ripërtrishme, dhe identifikimin e burimeve alternative dhe rialokimin e caqeve e parashikuara për gjenerim nga ujërat, në mënyrë që të zvogëlohej kapaciteti i planifikuar hidroenergjetik.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë është organ i pavarur është përgjegjëse për rregullimin e aktiviteteve në Sektorin e energjisë në Kosovë, përfshirë energjinë elektrike, ngrohjen qendrore dhe gazin, në pajtim me detyrimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Në vazhdim ZRrE lëshon licencat dhe monitoron respektimin e tyre nga ndërmarrjet e energjisë, dhe siguron që korniza rregulluese e Kosovës

të jetë në pajtim me 'acquiscommunautaire' (përmbledhja e legjislacionit të BE-së) për energjinë.

ZRrE është atakuar nga shoqëria civile për mos-respektim të kërkesave ligjore lidhur me lëshimin e autorizimeve finale për operuesit e hidrocentraleve. Gjatë takimit që KDI ka zhvilluar me përfaqësues të ZRrE³⁶ është mësuar se trajtimi i aplikacioneve për dhënien e autorizimeve nga ky organ trajtohet si një projekt, dhe nëse investitori posedon me lejet dhe pëlqimet përkatëse nga komuna, ministria e mjedisit, KOSTT dhe KEDS, atëherë ata e kanë të pamundur të refuzojnë një aplikacion për një investim strategjik shtetëror. Gjatë rishikimit të dosjes për ndërtimin e H3 Viça, ishte vërtetuar se investitori kishte të gjitha lejet paraprake për aplikim për autorizim final për ndërtimin e hidrocentralit.

(në rastin specifik Parku i Sharrit), Ministria e Zhvillimit Ekonomik/ZRRE, KOSTT, KEDS, Ministri e Infrastrukturës (nëse duhet kyçje në rrugë), ekzekutivi komunal, kuvendi komunal.

29 Palët përgjegjëse me përfaqësim të rregullt: MZHE, ZKM, MF, MMPH, MTI, APK, ZRrE, MAPL, KOSTT, KEDS, AKK

30 Rregullore (QRK) Nr. 05/2018 për one-stop-shop për burimet e ripërtitshme të energjisë

31 Për më shumë, kjo ministri kishte qëndruar e heshtur edhe ndaj reagimit të qytetarëve se në rastin e Hidrocentralit "Belaja" në Lumbardh të Deçanit investitori "KELKOS" kishte ndërprerë rrjedhën e plotë të lumit, duke shkelur kështu kushtet e lejes ujore dhe duke rrezikuar kështu florën dhe faunën e këtij lumi, si dhe burimet e ujit të pijshëm të komunës së Deçanit.

32 Burimet e energjisë nga era, uji, rrezet dhe biomasë.

33 Prodhimi nga hidroenergji

34 Studimi I parafisibilitetit për identifikimin e burimeve ujore për hidrocentrale të vegjël në Kosovë, 2006 – 75.22 MW prodhim nga HCV, Broshura Burimet e Ripërtitshme të Energjisë, MZHE (deri më 31 dhjetor 2019) – 128 MW.

35 Deklarata nga takimi me zyrtaret kompetent për energji të ripërtitshme lidhur me mini-hidrocentralet pranë MZHE, 30.09.2019

36 Takimi i datës 18 shtator 2019



VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

Procesi më i rëndësishëm në marrjen e pëlqimeve dhe le-
jeve të ndryshme për ndërtimin e hidrocentraleve, mbetet
Raporti i Vlerësimit të ndikimit në mjedis (VMN).

Kuadri ligjor³⁷ në Kosovë parasheh disa obligime të detyrueshme gjatë analizimit të ndikimit në mjedis për projekte të caktuara të cilat pasqyrohen në raportin e sipër cekur dhe shërben si bazë për marrjen e pëlqimit mjedisor, e cila është pikënisja e investimeve në projektin përkatës. MATKOS Group kishte dorëzuar VMN në MMPH në Mars 2013, dhe kishte marr pëlqimin mjedisor për këtë raport në dhjetor 2013.

Megjithatë, një raport i hartuar nga WWF Adria³⁸ në vitin 2015 me titull VNM/VSM për Projektet e Hidroenergjisë në Europën Juglindore, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Europian, ka shqyrtuar mangësitë e procesit të hartimit dhe shqyrtimit të raporteve të VNM-së në vendet e Europës Juglindore (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Serbi, Maqedoni, Mal i Zi, dhe Kosovë). Sipas këtij raporti, në veçanti është problematik fakti që Ministrinë të cilat duhet ta shqyrtojnë raportet e VNM-së dhe gjetjet e këtyre raporteve janë të kufizuara për shkak të mungesës së stafit me ekspertizë të duhur për ta kryer një shqyrtim të gjetjeve të raporteve të VNM-së.

MATKOS Group kishte përgatitur një VMN³⁹ për ndërtimin e katër hidrocentraleve në komunën e Shtërpçës. Ky raport i përgatitur nga MATKOS ishte i ndarë në 10 kapituj:

1. Hyrja,
2. Baza ligjore për hartimin e raportit,
3. Përshkrimi i lokacionit dhe mjedisit,
4. Përshkrimi i projektit,
5. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis,
6. Marrja e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve,
7. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis të hidrocentraleve,
8. Përputhja e planit me Planin Zhvillimor Komunal të Shtërpcës,
9. Masat rehabilituese pas përfundimit të aktivitetit të hidrocentralit,
10. Konkluzionet.

Krahasimi i përmbajtjes së këtij raporti me kërkesat e përcaktuara me ligjin për VNM, vë në pah se tri kërkesa specifike të përcaktuara me këtë ligj nuk janë përfshi në raport:

- Paraqitja e alternativave kryesore të identifikuara nga ana e aplikuesit dhe dhënia e arsyeve kryesore për zgjidhjen e njëres prej tyre, duke i marrë parasysh efektet mjedisore,

37 Kuadri ligjor i cili ka vendosur obligimin për hartimin e vlerësimit të ndikimit në mjedis është Ligji nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Deri në vitin 2014 kur është hartuar ky raport i VNM-së, kanë qenë të miratuara edhe 3 akte nënligjore që derivojnë nga ky ligj: (i) Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2011 për Licencimin e Hartuesve të Raporteve të Ndikimit në Mjedis, (ii) Udhëzimi Administrativ 09/2011 për Informim, Pjesëmarrje të Publikut dhe Palëve tjera të Interesuara në Procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, dhe (iii) Udhëzimi Administrativ nr. 08/2012 për Përcaktimin e Dokumenteve për Aplikim për Pelqim Mjedor sipas Llojit dhe Natyrës së Produkteve.

38 WWF Adria u krijua zyrtarisht në fillim të vitit 2015 megjithëse WWF ka gene aktiv në rajonin e Harkut Dinarik për më shumë se 15 vjet. WWF luan një rol kryesor në mbrojtjen e biodiversitetit të rajonit të Harkut Dinarik, pjesë e ekoregjionit më të madh mesdhetar dhe Danub-Karpatë. Me zyrën e saj qendrore në Zagreb, Kroaci, WWF Adria punon në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Mal të Zi, Maqedoni, IRJ*, Slloveni dhe Serbi. WWF Adria është një degë e Programit Mesdhetar WWF i krijuar nga WWF International për të mbrojtur pyjet, ekosistemet detare dhe ujërat e ëmbla në Mesdhe.

39 Raporti i Vlerësimit të ndikimit në mjedis, 2013



Hidrocentralet do të kenë ndikim të pranueshëm në baraspeshën natyrore të të ekosistemit të lumit Lepenc.”

Në vazhdim, raporti sipërfaqësisht trajton ndikimet në botën bimore dhe shtazore ku thuhet që **“nëse dëmtohet fondi i peshkut investitori duhet ta bëjë kompensimin në pajtim me rregulloret ligjore përkatëse”**. Ky formulim i përgjithësuar, pa pasur referencë dispozitat konkrete ligjore mbi të cilat mund të kërkohet ky kompensim, si realizohet ky kompensim, pa dhënë një pasqyrë të gjendjes ekzistuese të fondit të peshqve, si dhe pa dhënë një udhëzim se si mund të konstatohet dëmtimi i fondit të peshqve, nuk ka ndonjë vlerë.



Ndikimet më të rëndësishme në mjedis nga realizimi i këtij projekti janë në zvogëlimin e sasisë së ujit të lumit nga ku do të këtë ndikime negative në botën bimore dhe shtazore të lumit Lepenc”

- Përmbledhja jo-teknike e informatave të përshkruara në nenin 15 të Ligjit për VNM, dhe
- Shënimi i çfarëdo vështirësie - mangësie teknike ose mungesës së njohurive, në të cilat has aplikuesi gjatë hartimit të informatave të kërkuara.

Pjesa më e madhe e raportit përfshinë përshkrimin e lokacionit dhe mjedisit (kapitulli 3) dhe përshkrimin e projektit (kapitulli 4) dhe është përshkrim tekstual ("copy-paste") i projektit të hidrocentraleve, përfshirë përshkrimin e komponentëve të hidrocentraleve që janë praktikisht identike për të gjitha 5 HEC-et: vepra ujëmarrëse (e tipit malor-"Tiro"), dekantuesi, kanali i derivacionit, dhe ndërtesa e hidrocentralit.

Sa i përket ndikimeve të projektit gjatë fazës së ndërtimit, raporti konstaton që do të ketë "ndikime nga vajrat në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore." Gjithashtu në raport konstatohet me të drejtë që "do të ketë ndikime në ndotjen e ujërave nga pluhuri dhe grimcat e ngurta të cilat shkaktohen gjatë bartjes dhe vendosjes së gypit të derivacionit si dhe materialit tjetër." Dhe në fund, sa i përket ndikimeve gjatë fazës së ndërtimit konstatohet që "punimet brenda shtratit të lumit përkohësisht do ta dëmtojnë baraspeshën ekologjike të rrjedhës dhe do të ndikojnë në turbullimin e ujit." Këto efekte negative në ujëra, sipas raportit, do të jenë të përkohshme deri sa të zgjat faza e ndërtimit. Megjithatë raporti vlerëson se **"hidrocentralet do të kenë ndikim të pranueshëm në baraspeshën natyrore të ekosistemit të lumit Lepenc"**, pa dhënë asnjë shpjegim për këtë konstatim. Në anën tjetër, sa i përket ndikimeve gjatë fazës së funksionimit të hidrocentraleve, në raport konstatohet se **"ndikimet më të rëndësishme në mjedis nga realizimi i këtij projekti janë në zvogëlimin e sasisë së ujit të lumit nga ku do të ketë ndikime negative në botën bimore dhe shtazore të lumit Lepenc"**, pa dhënë detaje specifike se cilat bimë dhe shtazë, dhe në çfarë shkalle pritet të jetë ky ndikim.



Sa i përket ndikimit në ujë, disa prej ndikimeve të cilat nuk janë konsideruar në raport janë:

- Ndikimet në regjimin ujqor: zbritja e nivelit të ujërave nëntokësore në rrjedhën e lumit nën HEC ka ndikim negativ në vegjetacionin ujqor. Gjithashtu nuk janë analizuar ndikimet në shpejtësinë e rrjedhjes dhe në temperaturën e ujit. Problem në veti është që në raport nuk është shpjeguar se sa është saktësisht prurja e pranueshme ekologjike e cila duhet të lëshohet në lumë (thuhet që do të jetë 30-35%), si është përcaktuar ajo dhe si do të mbikëqyret kjo prurje gjatë fazës së operimit të HEC-eve. Ky është një problem në vete duke pasur parasysh që rreth 15 km sipas VNM janë paraparë të futen në gypa në gjatësi prej më pak se 30 km distancë ku janë planifikuar të ndërtohen katër hidrocentrale të vogla.
- Ndikimet në transportin e sedimentit (inerteve): për shkak të zvogëlimit të shpejtësisë së rrjedhjes së ujit rritet sedimentimi në pjesën e akumulimit që rezulton me zvogëlim të transportit të tij në rrjedhën e lumit nën digë që mund të shkaktojë thellimin e shtratit të lumit, e që mund të ndikojë në habitatet ujqore.
- Pengesat e migrimit: me ndërtimin e digës ndërpritet kontinuiteti i lumit që paraqet pengesë për lëvizjen e organizmave ujqorë, para së gjithash të peshqve por edhe të organizmave tjerë ujqorë.
- Ndikimet kumulative nga ndërtimi i 5 HEC-eve: ndikimi më i rëndësishëm negativ kumulativ i 5 HEC-eve është fragmentimi dhe lidhshmëria e reduktuar i sistemit lumor dhe tokësor.

Edhe pse në raport është konstatuar që si një nga masat për mbrojtjen e peshqve dhe organizmave tjerë akuatik duhet të ndërtohet shtegu i peshqve, nuk janë dhënë detaje dhe udhëzime se si duhet të ndërtohet i njëjti, para

së gjithash me çfarë shpejtësie të lëvizjes së ujit duhet të dizajnohet, çfarë pjerrtësie duhet ta këtë, ku duhet të vendoset, etj. që janë elemente jashtëzakonisht të rëndësishme për funksionalitetin e shtegut të peshqve.

Raporti në fjalë, nuk trajtonte në asnjë pjesë ndikimet që ndërtimi i hidrocentraleve mund të kishin në rendimentin bujqësor dhe ndikimet e tjera sociale.

Programi i monitorimit të ndikimeve është sipërfaqësor dhe stereotipik me formulime të përgjithësuara, pa i specifikuar qartë dhe saktë ndikimet e mundshme, masat zbutëse dhe mekanizmat e monitorimit për sigurimin e zbatimit të masave⁴⁰. Në kapitullin e 9 të raportit trajtohet, me një paragraf, situata potenciale e ndërprerjes së aktivitetit të hidrocentraleve dhe rrjedhimisht demontimi dhe largimi i hidrocentraleve. Në këtë kontekst raporti sugjeron hartimin e një raporti të ri të VNM-së për ta adresuar një situatë të tillë hipotetike. Në vazhdim raporti në fjalë nuk trajton procedurat e matjes së prurjes ekologjike. Në përgjithësi, raporti i VNM-së për hidrocentralet në lumin Lepenc është i një niveli të dobët teknik dhe përmbytësor⁴¹.

⁴⁰ Bazuar në Udhëzuesin e Bashkimit Evropian për Hartimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis: Programi i monitorimit duhet të jetë i detajuar në masë të mjaftueshme në mënyrë që të mundësojë zbatimin e masave për zvogëlimin e ndikimeve në mjedis. Ky program do të duhej të përfshinte: parametrat që duhet të monitorohen, shpeshtësinë e monitorimit, metodat e monitorimit, përgjegjësitë dhe resurset për monitorim. Masat e monitorimit janë një ndihmesë që të sigurohet se projekti i përmbytsh kërkesat ligjore dhe që ndikimet janë në përputhje me projeksionet e raportit të VNM-së. Këto masa duhet të përfshihen në vendimin për dhënien e pëlqimit mjedisor

⁴¹ Sipas vlerësimit të Ekspertit për politikën ujore Afrim Lajçi, Inxhinier i ujërave



Kushtet e dhëna nga MMPH kundrejt mangësive vlerësuese dhe planeve të veprimit të VMN-së, theksojnë mungesën e një Udhëzuesi për hartimin dhe shqyrtimin e raporteve të VNM-së është një hendikep i madh për zhvillimin kualitativ të procesit të VNM-së.

Kushtet e definuara në pëlqimin mjedisor të dhënë nga MMPH nuk trajtojnë asnjërin nga mangësitë e cekua më lartë, duke u limituar në: (1) projektimin e veprës së marrjes me dalje portative me qëllim të lëshimit të elementeve të suspenduara; (2) të ndërmerren masat për evitimin e ndotjes së mjedisit nga mbetjet inerte, vajrave dhe karburanteve gjatë ndërtimit; (3) të mos lejohet marrja e sasisë së ujit si prurje minimale biologjike; (4) të implementohet plani aksional për aksidente; (5) të merren masat rehabilituese në rast të ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit; dhe (6) që përveç kushteve të sipër cekura, investitori duhet t'i përmbahet edhe kushteve të përshkruara në VNM. Nxjerrja e këtij Udhëzuesi ka qenë obligim i MMPH-së (që është dashur të pëmbushet deri në prill të vitit 2011), si dhe ve një në pah kapacitetet e kufizuara të ekspertizës së duhur për shqyrtimin e raporteve të VNM-së brenda MMPH-së, si një pengesë tjetër serioze për zhvillimin e një shqyrtimi adekuat të raporteve të VNM-së⁴².

Sipas Komisionit Botëror për Pendat⁴³, arsye tjera të cilat shtyjnë qeveritë në mos trajtimin e duhur të VMN-ve janë:

- Legjislacionet e pakompletuara dhe dy kuptimësi
- Vështirësitë në definimin e specifikimeve të kërkesave shoqërore dhe mjedisore

⁴² Vlerësimi i ndikimit në mjedis të projekteve: Udhëzim për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Bashkimi Evropian, 2017, dhe Hyrje në vlerësimin e ndikimit në mjedis, Glasson J., Therivel R, dhe Chadwick A, 2012

⁴³ The Report of the World Commission on Dams, fq. 185

Mungesa e transparencës, llogaridhënies dhe mundësitë për korrupsion në procesin e vendimmarrjes;

- Mungesa e pjesëmarrjes kuptimplote në pikat kryesore në procesin e vendimmarrjes
- nivele të ulëta të monitorimit të brendshëm dhe të jashtëm në procesin e vendimmarrjes
- Resurset ligjore të dobëta ose jo-ekzistuese dhe mekanizmat e ankesave në një gjyqësor të pavarur, veçanërisht për grupet e ndejshme dhe të prekshme
- Limitimet buxhetore dhe njerëzore të institucioneve përkatëse.



Nëse dëmtohet fondi i peshkut investitori duhet ta bëjë kompensimin në pajtim me rregulloret ligjore përkatëse”


KONFLIKTI I SHFRYTËZIMIT TË BURIMEVE UJORE NË LEPENC

Në vitin 2016 Fondi për Investime në Ballkanin Perëndimor kishte aprovuar MMPH-së grantin fillestar prej 1.5 milion Euro⁴⁴ për Studimin e fizibilitetit për ndërtimin e kanalit të Ibër-Lepencit, përfshirë studimin e fizibilitetit për ndërtimin e pendave akumuluese sipërfaqësore në Firajë dhe Shtime. Në vazhdim, Korniza për Investime në Ballkanin Perëndimor, në përputhje me Direktivën Kornizë të BE për ujërat 2000/60 EC, kishte aprovuar edhe mbështetjen për projektin e “Ndërtimit të fazës së dytë të hidrosistemit Ibër-Lepenc”⁴⁵ në vlerë prej 98,672,000.00 Euro në përgjegjësi të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. Përfitues të këtij projekti do të jenë 500,000 banorë të Kosovës, dhe në rast të mosrealizimi i tij, do të paraqiste rrezik për zhvillim të përgjithshëm të vendit.

Ndërmarrja Hidroekonomike “IbërLepenci” SH.A. që nga viti 2015 në vazhdimësi kishte njoftuar institucionet kyçe⁴⁶ për të ndërprerë punimet e këtyre mini HC. Sipas Ibër-Lepencit do të kenë ndikim në përfundimin e projektit “Lepenci”, i cili është projekt strategjik/kombëtar për aspektin e furnizimit me ujë të pijshëm.

Si konkluzion, Ministria e Mjedisit, për të njëjtën hapësirë, për të njëjtin burim ujor ka dy projekte në zhvillim e sipër, të cilat sigurisht përjashtojnë njëra tjetrën. Por që projekti i Ibër-Lepencit ka përparësi në zhvillim bazuar në faktin që uji për nga prioriteti së pari duhet të sigurohet për pije e më pas për nevoja të tjera.

Po ashtu, fillimi i këtij projekti madhor është në vitet ‘60-ta, që do të thotë se edhe në aspektin kohor projekti i Ibër-Lepencit ka përparësi për shfrytëzim të burimit ujor të lumit Lepenc.



44 KIBP, Nr. i grantit WB14-KOS-ENV-01, shkurt 2016

45 KIBP, Numri i projektit 011DU

46 Njoftime e datës 21.09.2015-Zyrës së kryeministrit; 06.04.2017-Zyrës së Kryeministrit; 27.03.2018-MMPH-së; 19.03.2018-Zyrës së Kryeministrit

KONKLUZIONET

Studimi në fjalë, edhe pse i fokusuar në një rast të vetëm trajtimi (HC H3 Viça) shpërfaq probleme të shumta në koordinimin e institucioneve publike përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë mjedisore.

Një Strategji MZHE, e nxituar për Burimet e Ripërtrishme të Energjisë, dhe jo e analizuar mirë kundrejt potencialeve natyrore, kishte rezultuar në vërsuljen e investorëve në investimeve kapitale në resursin më të paktë natyror në Kosovë, ujin. Me qëllim të përmbushjes së kuotave të pajtuara në nivel Global, dhe politikave të BE që deri në vitin 2020, 20% e energjisë së nevojshme për konsum të gjenerohej nga Burimet e Ripërtrishme Energjetike (BRE), MZHE si një metodë më e lehtë dhe e lirë e investimeve kishte identifikuar investimet në hidro-energji. Kjo strategji përveç që nuk ishte mbështetur në studime të ndikimeve mjedisore, ishte e bazuar në të dhëna të vjetërsuara.

Për më shumë, Ministria e Mjedisit që ishte pjesë e grupit punues dhe Task Forcës për ujëra (tash këshilli ndërministror) nuk kishte ngritur shqetësime lidhur me ndikimet mjedisore nga këto investime kapitale në lumenjtë e Kosovës.

Raporti për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor për HC Viça 3 kishte mangësi thelbësore, duke mos trajtuar ndikimet në bujqësi, shoqëri, si dhe duke trajtuar sipërfaqësisht ndikimet në florë dhe faunë, pa dhënë një program konkret për mbrojtjen e mjedisit dhe sanimin e dëmtimeve të mundshme. Këto mangësi ngritin shqetësime lidhur me profesionalizmin e ekspertëve të licencuar për hartimin e raporteve të VMN-së.

Ministria e Mjedisit nuk kishte bërë një vlerësim profesional të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis për HC Viça 3, duke aprovuar një VNM që nuk trajtonte ndikimet sociale, ndikimet bujqësore, dhe ato në florë dhe faunë ishte sipërfaqësore. Raporti kishte cekur se “ndikimet më të rëndësishme në mjedis nga realizimi i këtij projekti janë

në zvogëlimin e sasisë së ujit të lumit nga ku do të këtë ndikime negative në botën bimë dhe shtazore të lumit Lepenc”, pa dhënë detaje specifike se cilat bimë dhe shtazë, dhe në çfarë shkalle do të ketë ndikim. Sipas VNM-së në fjalë, ndikimi në mjedis ishte sipërfaqësor, edhe pse do të ndërtoheshin katër hidrocentrale të vogla në një distancë prej më pak se 30 km gjatësi, ku rreth 15 km parashihej të futeshin në gypa 60-65% e rrjedhës së lumit. Për më shumë në komunën e Shtërpçës janë rreth 4000 hektar toka bujqësore, ku vetëm 25% e tyre janë të mbuluara me sisteme publike të ujitjes.

Ministria i kishte dhënë pëlqimin Investitorit për ndërtim, pa përfillur detyrimet ligjore që sigurojnë pjesëmarrjen e komunitetit në vendim-marrje për proceset e vendimet që kane ndikim mjedisor.

Ministria e Mjedisit, kishte marrë aprovimin nga KIBF të projektit në vlerë prej 100 milion €, si dhe dy pjesë të grantit për përfundimin e fazës II të projektit hidro-ekonomik “Ibër-Lepenci”, megjithatë kishte vazhduar me dhënien e lejeve për ndërtim të HC në pellgun e Lepencit, duke ditur që në pikën e paraparë akumuluese në Firajë, H3 Viça dhe pike marrja e Hidrocentralit në Sllatinë do të fundoseshin tërësisht. Veprimet e tilla të MMPH-së rrezikojnë për humbje të buxhetit shtetëror duke krijuar detyrime ndaj investorëve për koston e investimeve të lejuara dhe tarifën e garantuar të shitjes për 10 vite operim.

**Ministria e Infrastrukturës, si bartëse e përgjegjësjëve
paraprakisht të Ministrisë e Mjedisit dhe Planifikimit
Hapësinor:**

1. Duhet të pezulloj ndërtimet e hidrocentraleve në gjithë territorin e Kosovës deri në kryerjen e një studimi të detajuar të kapaciteteve ujore dhe prioriteteve në shfrytëzimin e resurseve ujore.
2. Duhet të kryejë vlerësimin e prurjeve ekologjike dhe ndikimeve mjedisore nga investimet në hidrocentrale për ato që janë ndërtuar (p.sh. Modeli hidrodinamik MIKE 11);
3. Duhet të kategorizoj shfrytëzimet ujore, dhe hartoj zonimin e lumenjve, me qëllim që rrjedhat ujore ku prioritet është uji i pijshëm, uji për agrikulturë dhe rrjedhat ujore brenda parqeve kombëtare të mos preken;
4. Duhet që me prioritet të hartoj Udhëzimin Administrativ për shqyrtimin e raporteve të vlerësimit të ndikimeve në mjedis;
5. Duhet që me prioritet të përditësoj Udhëzuesin Administrativ për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut konform Samitit të Tokës së Rios (OKB) 1992; Konventën Aarhus (1998), dhe Direktivën e BE-së e 2003 dhe për përfshirjen e publikut në vendimmarrjen rreth investimeve me ndikim mjedisor.
6. Duhet të harmonizoj aktivitetet ndërmjet dikastereve të ndryshëm të kësaj ministrie.
7. Duhet të hartoj një udhëzues administrativ për përcaktimin e përgjegjësive dhe mbikëqyrjen e ekspertëve të licencuar për përpilimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis.
8. Ministria e Zhvillimit Ekonomik të rishikoj Strategjitë Shtetërore për Burimet të Ripërtrishme Energjetike, për të ulur ngarkesën e prodhimit nga burimet ujore;
9. Të krijohet një mekanizëm bashkëpunimi ndërmjet

10. Prokuroria e shtetit të fillojë menjëherë hetimet në lidhje me dyshimet për korrupsion, degradim të mjeshterit dhe keqpërdorim të ujërave sipas kallëzimit penal të dërguar nga banorët e Bitisë e Poshtme.

Në qershor 2019, banorët e fshatit Biti e Poshtme, pas katër vitesh protesta të vazhdueshme, kishin kërkuar ndihmën e shoqërisë civile në kauzën e tyre për ndalimin e ndërtimit të hidrocentralit H3 Viça. Përveç sensibilizimit të çështjes përmes partnerëve nga mediat, shoqëria civile kishte komunikuar edhe me komisione të kuvendit dhe Avokatin e Popullit. Duke parë mungesën e vullnetit politik të Ministrisë së Mjedisit që të adresonte këtë çështje, në nëntor 2019 shoqëria civile kishte organizuar një peticion në nivel kombëtar, për ndalimin e ndërtimit të hidrocentraleve të vogla në lumenjtë e Kosovës. Këtij peticioni u ishin përgjigjur rreth 28,000 qytetarë të Kosovës. Peticioni i nënshkruar do t'i dorëzohet legjislaturës së VII-të në tremujorin e parë të vitit 2020. Për më shumë, gjetjet nga hulumtimi i rastit rreth shkeljeve ligjore dhe dyshimet rreth krijimit të detyrimeve ndaj investitorëve duke u lejuar të investojnë në territorin e projektit madhor Ibër-Lepenci, ishin dorëzuar nga KDI në Prokurorinë e shtetit në nëntor 2019.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

627.8:504(496.51)(047)

Krasniqi Metushi, Diana

Ujë pak e nevoja shumë : ndikimi i investimeve kapitale
në mjedis : ndërtimi i hidrocentralit H3 viça : shkurt 2020 /
Diana Metushi Krasniqi. – Prishtinë : Instituti Demokratik i
Kosovës, 2020. – 24 f. : ilustr. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-745-34-5

THIRR

**0800
77 777**

RAPORTO KORRUPSIONIN

**KORRUPSIONI
PAMUNDËSOHET
KUR RAPORTOHET**

ISBN 978-9951-745-34-5



9 789951 745345

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

